

MANUAL PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI I SHUMËFISHTË

Për anëtarët e komunitetit
Rom, Ashkali dhe Egjiptian
LGBTI + në Kosovë

IMPRESSUM


Botuesi:
Civil Rights Defenders

Për botuesin:
Goran Miletić
Drejtor për Europën

Autore:
Rajmonda Sylbije
Rita Selimi

Dizajni:
Marko Kovačevski

Kopje:
50



MANUAL PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI I SHUMËFISHTË

Për anëtarët e komunitetit
Rom, Ashkali dhe Egjiptian
LGBTI + në Kosovë

PËRMBAJTJE

1. Hyrja	6
1.1.1. Situata e personave LGBTI+ në Kosovë.....	6
1.1.2. Situata e personave Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë.....	7
2. Korniza ligjore.....	8
2.1. Diskriminimi i shumëfishtë, koncepti i përgjithshëm dhe përfshirja ligjore në nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar.....	9
2.2.1. Perspektiva ligjore e diskriminimit të shumëfishtë.....	10
3. Institucionet e pavarura dhe organizatat e shoqërisë civile.....	12
3.1.1. Institucionet e pavarura.....	12
3.1.2. Organizatat e shoqërisë civile.....	14
4. Mjetet praktike dhe strategjitë për të trajtuar diskriminimin e shumëfishtë.....	15
4.1.1. Regjistrimi dhe dokumentimi i diskriminimit të shumëfishtë.....	15
4.1.2. Efektet psiko-sociale të diskriminimit të shumëfishtë.....	15
4.1.3. Gjetja e aleatëve dhe ndërtimi i komunitetit.....	16
4.1.4. Mbledhja e mbështetjes publike kundër diskriminimit - fushata (veprime publike dhe dixhitale, peticione, advokim)	16
5. Burime/Kontakte	17
6. Bibliografia.....	18

1. HYRJA

Kur flasim për çështjet që prekin nocionin e “gjinisë”, “seksualitetit”, “etnisë” zakonisht mendohet dhe diskutohet vetëm mbi pjesën ku përket mazhoranca e shoqërisë dhe çdo gjë tjetër që dallon nga e zakonshmja apo ajo që është tipike, në kontekste të caktuara kulturore konsiderohet si jo e rëndësishme, e imponuar apo pothuajse jo ekzistente. Dija dhe e vërteta mbi çështje të caktuara shoqërore janë produkt i konstruksionit social. Kësisoj, historikisht individë dhe grupe të cilat kanë bartur karakteristikat që shoqërisht janë perceptuara si “ndryshe” janë përjashtuar, diskriminuar dhe përndjekur. Personat LGBTI+ dhe komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë po ashtu perceptohen më ndryshe, ku raportet e ndryshme na tregojnë që situata e tyre e përgjithshme karakterizohet me probleme të ndryshme sociale.

Të dy grupet mund të konsiderohen si pjesë e cenueshme e shoqërisë, e që për shkak të sistemit, strukturës sociale dhe mendësisë kulturore ata kanë më shumë predispozita që të ballafaqohen me sfida të ndryshme e ndër to, përjetimi i stresit dhe vështirësive emocionale. Meyer (2003) identifikon një model të teorisë së stresit të pakicave që pohon se përjetimi i stresit që iniciohet nga mjedisi social sjell probleme të shëndetit fizik dhe emocional tek grupet e cenueshme. Teoria e Meyer zakonisht është përdorur për të shpjeguar dhe problematizuar çështjen e shëndetit mendor dhe sjelljet e rrezikshme tek personat LGBTI+ por i njëjti model mund të përdoret për të shpjeguar edhe përvojën e grupeve tjera të shtypura. Teoria sugjeron se janë faktorë të dy dimensioneve që prodhojnë stresin: faktorët e jashtëm që krijohen dhe mirëmbahen nga rrethi shoqëror e që zakonisht paraqiten në formën e diskriminimit dhe përjashtimit dhe faktorët e brendshëm që internalizohen nga grupet dhe që paraqiten në format e paragjykimëve, bindjeve të internalizuara, vetë-fajësimi etj¹. Eksperienat e tilla mund të kenë barrë më të madhe kur individët kanë jo një por disa karakteristika që kanë predispozita më të mëdha të stigmatizohen nga faktorët e jashtëm.

Personat LGBTI+ dhe komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në parim, janë grupe të shtypura në shoqëri por eksperienat, nevojat dhe vështirësitë jo doemos janë të njëjlojshme. Megjithatë, shumë shpesh këto dy identitete takohen me njëra-tjetrën duke krijuar pastaj një përvojë dyfish diskriminuese. Crenshaw (1989, 1991) propozon konceptin e ndërthurshmërisë (intersectionality) si kornizë teorike për të shpjeguar se si tipare/aspekte të ndryshme të individit kombinohen/ndërthurren për të krijuar situata të reja të diskriminimit apo privilegjit. Në studimet e saj të hershme, Crenshaw argumenton mbi bazën e gjinisë dhe racës dhe ndërthurshmërinë e këtyre të dyjave në dhunën që përjetojnë gratë². Teoria e njëjtë në rrethet akademike tani përdoret për të shpjeguar edhe ndërthurshmërinë e identiteteve në baza tjera si gjinia, raca, orientimi seksual, klasa, religjioni etj. dhe për të identifikuar sesi ndikojnë marrëdhëniet mes faktorëve tek ata që janë më të marginalizuar në shoqëri duke i konsideruar këto marrëdhënie si të rëndësishme për të kuptuar dhe krijuar programe që synojnë barazinë shoqërore dhe politike.

Duke pasur parasysh të gjetura të tilla dhe realitetin e situatës së këtyre grupeve, është esenciale që çështjeve të personave LGBTI+ Rom, Ashkali dhe Egjiptian t'i qasemi në bazë të konceptit të ndërthurshmërisë në mënyrë që të identifikohen dhe merren parasysh të gjithë faktorët që kombinohen tek një individ/grup për t'i pozicionuar ata në hapësirën sociale. Po ashtu, në mënyrë që të ndërtohen politika dhe programe që synojnë zbutjen e pabarazisë, diskriminimit, përjashtimit dhe promovimin e barazisë sociale duhet të kuptohen edhe disavantazhet e shkaktuara nga ndërthurja.

Ky botim, vjen si pjesë e projektit “Fuqizimi i personave Rom LGBTI + dhe organizatave të shoqërisë civile në rajonin e Ballkanit” që mbështetet nga Instituti Suedez dhe zbatohet nga Civil Rights Defenders. Manuali ka për qëllim ofrimin e udhëzimeve për mbrojtjen nga diskriminimi i shumëfishtë për anëtarët e komunitetit Rom LGBTI+ dhe është botuar në 5 shtete: Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Bosnie Hercegovinë, Serbi dhe Shqipëri.

Ky manual ofron një hyrje të përgjithshme të situatës dhe kontekstit socio-kulturor Kosovar të personave LGBTI+ dhe komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, prezanton kornizën ligjore dhe institucionale, definon konceptin e diskriminimit të shumëfishtë dhe ofron strategji dhe rekomandime konkrete në trajtimin e tij.

1.1.1. Situata e personave LGBTI+ në Kosovë

Personat LGBTI+ historikisht konsideroheshin të ishin një grup që në krahasim me pakicat e tjera ndryshonin në bazë të faktit se nuk kanë ndonjë karakteristikë të dukshme që i dallon nga shumica dhe ekzistenca e tyre është konsideruar si kërcënuese për rregullat natyrore³. Në shoqëri të tilla heteronormative ku përcaktohet çfarë është e vërtetë dhe çfarë është e pranueshme, e ku dominon bindja se çdokush është heteroseksual dhe se vetëm këto marrëdhënie janë natyrale, tipike dhe të vlefshme, të qenurit person LGBTI+ bëhet gjithmonë e më sfiduese. Vështirësitë që pasojnë janë të segmenteve të ndryshme si sociale, psikologjike, ekonomike dhe shumë shpesh këto janë të ndërthurura me njëra-tjetrën. Këto vështirësi i vendosin personat LGBTI+ në margjinat e shoqërisë duke u pamundësuar dhe vështirësuar përfshirjen në situata tipike shoqërore, sepse në shoqëritë kolektivistike për të qenë pjesë e grupit duhet të bindesh dhe të respektohet normat dhe praktikat që shihen si të mirëqena. Në rastet kur dikush konsiderohet se dështon t'i përmbushë ato, atëherë ndodh stigmatizimi dhe përjashtimi social⁴. Në kontekste të caktuara socio-kulturore, personat LGBTI+ perceptohen si diçka e imponuar por asesi e përputhshme me normat dhe zakonet e mirëmbajtura shoqërore. Kësisoj, personat LGBTI+ duket se janë vazhdimisht në “betejë” me mendësinë kulturore dhe diskriminimet e shumta që vijnë si pjesë e vlerave dhe traditave kulturore. Në Kosovë, kjo situatë është

1 Meyer I. H. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: conceptual issues and research evidence. *Psychological bulletin*, 129(5), 674–697.

2 Crenshaw, K. (1993). Mapping the Margins: Intersectionality, Identity Politics, and Violence Against Women of Color. *Stanford Law Review* Vol. 43, No. 6

3 Gross, Larry (1991). Out of the Mainstream: Sexual Minorities and the Mass Media. *IN: Journal of Homosexuality* 21(1/2):19-46

4 Abrams, D., Hogg, M.A. & Marques, J.M. (2005). *The Social Psychology of Inclusion and Exclusion*. New York: Psychology Press.

tipike dhe në studimin e NDI (2015) Kosova del të jetë një prej vendeve me homofobinë më të lartë në Ballkan⁵ ku 97% të të pyeturve deklaruan nuk do të shoqëroheshin me dikë i cili identifikohet si person LGBTI⁶.

Homofobia nënkupton qëndrimet dhe ndjenjat negative ndaj njerëzve që identifikohen apo perceptohen si lezbike, gej dhe biseksual⁷.

Në këto rrethana, duke qenë person LGBTI+ është shumë më e mundur që të ballafaqohesh me diskriminim, dhunë dhe jo-tolerancë. Në Kosovë, një numër i konsiderueshëm i personave LGBTI+ kanë predispozita për të fshehur seksualitetin e tyre dhe 73% shmangin lokacione të caktuara për arsye sigurie. Sipas studimeve të deritanishme, 82% e rasteve LGBTI+ kanë qenë verbalisht të abuzuar, ndërsa 50% prej tyre kanë përjetuar edhe dhunë fizike.⁸ Qëndrimet homofobike nga mazhoranca e shoqërisë kombinuar me korniza ligjore formalisht të rregulluara mirë por me nivel jo të kënaqshëm të implementimit, bëjnë që personat LGBTI+ t'i ekspozohen shkeljeve të të drejtave të njeriut në baza ditore. Por, pavarësisht eksperienave personale dhe realitetit që na shpërfaq një nivel të lartë të diskriminimit dhe dhunës apo ligjeve në fuqi që në një formë vendosin rrugën për të shtyrë çështjen e të drejtave deri në instancat më të larta institucionale, nuk ekziston një praktikë e raportimit të rasteve sepse ekziston bindja se institucionet nuk do të ndër marrin asgjë⁹.

Përveç, perceptimit të përgjithshëm shoqëror mbi personat LGBTI+, situata dhe qëndrimet e familjes po ashtu nuk janë aq mikpritëse. Familja është konceptuar të jetë mjaft përjashtuese edhe e rreptë në pranimin e pjesëtarëve që nuk janë heteroseksual. Mohimi dhe përpjekja për ta “shëruar” janë dy situatat tipike të familjes kur fëmija hapet mbi orientimin seksual, ku edhe në Kosovë rreth 41% deklaruan se do ta ndihmonin fëmijën e tyre të gjejë një “kurë” në qoftë se do pohonte se është person LGBTI+. Refuzimi nga familja pastaj ka pasojat e veta si vetë-mohimi i identitetit apo fillimi i një jete të dyfishtë ku shumë persona hyjnë në martesë me njerëz të seksit të kundërt. Këto strategji shihen si më të favorshme nëse duan të jetojnë në rrethet familjare, ku shpesh janë të varur ekonomikisht. Në Kosovë, “identiteti i mohuar” është rruga më e sigurtë sepse studimet tregojnë se 52% e individëve LGBTI+ janë të frikësuar për t'i treguar orientimin seksual familjarëve dhe 13% janë viktime të dhunës verbale dhe rrezikut për t'u përjashtuar nga familja¹⁰.

Situatat e lartpërmendura janë pasqyrë e pjesshme, por që na ndihmojnë të kuptojmë realitetin ditor të personave LGBTI+. Pabarazitë dhe vështirësitë në segmente të ndryshme funksionojnë vetëm dhe në ndërthurje me njëra tjetrën, duke krijuar kështu një rreth vicioz ku dy apo më shumë elemente intensifikohen dhe përkeqësojnë njëra tjetrën. Një rast ilustrues për personat LGBTI+ do të ishte situata kur një person LGBTI+ në nivelin mezo-social ballafaqohet me nënçmim, diskriminim, stigmatizim apo përjashtim, kjo do të reflektohet edhe në nivelin mikro-social duke ndikuar kësaj raportin intrapersonal dhe interpersonal.

Kësisoj, Kosova edhe në vlerësimin e fundit vjetor të ILGA (2019) ka arritur 33% sa i përket reformës ligjore dhe politike. Ky indeks mat standardet ligjore dhe të politikave në fushat e barazisë dhe mosdiskriminimit, të drejtat e familjes, krimin dhe gjuhën e urretjes, njohjen ligjore të gjinisë dhe integritetit trupor, lirinë e mbledhjes, shoqërimin, dhe shprehjes si dhe azil kërkimin.

1.1.2. Situata e personave Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë

Në Kosovë, sipas të dhënave të fundit zyrtare të regjistrimit të popullsisë afërsisht rreth 35,784 persona te komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian banojnë në Kosovë¹¹. Situata e personave Rom, Ashkali dhe Egjiptian ka ndryshuar gjatë periudhave të ndryshme kohore - deri në vitet e '90 si grup ishin shumë më diversë dhe gjuha e folur ishte kryesisht ajo rome, shqipe apo serbo-kroate. Por, pas kësaj periudhe grupi është ndarë në tre grupe vetë-identifikuese si Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe gjuha e folur nga komuniteti Rom është zakonisht romisht apo serbisht ndërsa nga komuniteti Ashkali dhe Egjiptian flitet gjuha shqipe si gjuhë e parë¹². Pavarësisht prezencës shumë vjeçare të komunitetit në Kosovë, personat Rom mbeten një ndër komunitetet më së paku të integruara në proceset shoqërore. Komunitetet e tilla që janë pak apo aspak të integruara në shoqëri, me doemos ekspozohen edhe ndaj padrejtësive, pabarazive e mohimeve të tjera shoqërore.

Në Kosovë, diskriminimi sistematik është një prej shkaqeve kryesore që shpien komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në margjinat e shoqërisë duke e përjashtuar kështu nga domenet e ndryshme shoqërore. Perceptimi negativ shoqëror dhe diskriminimi i shumëfishtë ndaj komunitetit ndodh në nivele të ndryshme, qoftë institucionale apo shoqëror. Një nga padrejtësitë kryesore për të ardhmen e komunitetit sigurisht është qasja në edukim. Në institucionet e edukimit, komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian ndër vite është përballur me stereotipe të ndryshme

5 National Democratic Institute (2015). LGBTI Public Opinion Poll in Western Balkans.

https://www.lgbti-era.org/sites/default/files/pdfdocs/LGBTI%20Poll%202015%20Western%20Balkans%20NDI%20.pdf

6 World Bank Group (2018). Life on the Margins: Survey Results of the Experiences of LGBTI People in Southeastern Europe

http://documents1.worldbank.org/curated/en/123651538514203449/pdf/130420-REPLACEMENT-PUBLIC-FINAL-WEB-Life-on-the-Margins-Survey-Results-of-the-Experiences-of-LGBTI-People-in-Southeastern-Europe.pdf

7 Renzetti, C. & Edleson, J. (2008). *Encyclopedia of Interpersonal Violence*. SAGE Publications.

8 World Bank Group (2018). Life on the Margins: Survey Results of the Experiences of LGBTI People in Southeastern Europe

http://documents1.worldbank.org/curated/en/123651538514203449/pdf/130420-REPLACEMENT-PUBLIC-FINAL-WEB-Life-on-the-Margins-Survey-Results-of-the-Experiences-of-LGBTI-People-in-Southeastern-Europe.pdf

9 ibid

10 YIHR (2013). Liria dhe mbrojtja për lezbiket, homoseksualet, biseksualet dhe transjinoret në Kosovë. Marrë nga: https://ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf

11 Civil Rights Defenders (2017). The wall of anti-Gypsism. <https://crd.org/wp-content/uploads/2018/03/The-Wall-of-Anti-Gypsism-Roma-in-Kosovo.pdf>

12 Minority Right Group International (2018). Roma, Ashkali and Egyptians. Marrur nga: <https://minorityrights.org/minorities/roma-9/>

që janë krijuar dhe mirëmbajtur. Të tilla stereotipe që kanë bërë të vështirë e shpesh të pamundur pjesëmarrjen direkte. Niveli i braktisjes së shkollimit mbetet ende i lartë dhe shqetësues tek këto komunitete¹³, megjithëse ka pasur përmirësim në këtë aspekt falë programeve të shoqërisë civile dhe institucioneve të organizatave ndërkombëtare¹⁴. Pjesëmarrja e zbehtë në arsim pastaj reflektohet edhe në tregun e punës ku qeveria e Kosovës vlerëson se shkalla e papunësisë tek komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian është pothuajse rreth 95%. Mungesa e qasjes në sektorin publik dhe diskriminimi nga sektori privat e vështirësojnë mundësinë e komuniteteve për tu punësuar. Kjo situatë është edhe më e keqe për gratë rome ku 9 nga 10 gratë rome nuk janë të punësuar.

Në aspektin shëndetësor dhe atë të banimit, komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian ende ballafaqohet me kushte të dobëta jetese. Për shkak të diskriminimit dhe kostove të trajtimit zakonisht nuk marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore. Karakteristikë për situatën e Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve është dhe fakti se ata zakonisht jetojnë në pjesët e qytetit (afër deponive të mbeturinave) që e dëmtojnë cilësinë e jetës¹⁵. Pozicionimi në hapësira me kushte jetese tejet të dobëta përkthehet me faktin se në studimin në 2013-2014 del se jetëgjatësia e komunitetit rom është rreth 58.3 vjet¹⁶.

Të dhëna të tilla na tregojnë se komunitetet Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian ballafaqohen me një 'dhunë simbolike' që mirëmban pozitat klasore brenda strukturës shoqërore. Në këtë mënyrë, përmes mungesës së politikave dhe programeve jo-holistike në shoqëri legjitimohet diskriminimi. Këto rrethana nënkuptojnë që për shkak të pozitës së kamotshme në marginat e shoqërisë, grupet e cënueshme kanë gjasë që të internalizojnë pozitën e tyre dhe të marrin si të mirëqenë trajtimin e padrejtë që hasin çdo ditë.

2. KORNIZA LIGJORE

Në vazhdim do të prezantohet korniza ligjore kombëtare e Kosovës, duke dhënë një pasqyrë të disa prej ligjeve në fuqi që mbrojnë apo kanë për bazë orientimin seksual, identitetin gjinor, etninë, racën dhe karakteristikat tjera. Po ashtu, do të prezantohet koncepti i diskriminimit të shumëfishtë (dhe përfshirja ligjore në nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar.

2.1.1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Kosovës bazohet në parimet e barazisë, lirisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale mes vlerave të tjera. Kosova tërë kornizën ligjore e ka të fuqizuar përmes aplikimit të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut në përgjithësi. Kushtetuta e Kosovës kësaj mbron edhe personat LGBTI+ dhe i njeh grupet etnike si komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ku garanton të drejtat individuale dhe kolektive në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.¹⁷

2.1.2. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi Nr. 05/L-021

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e qytetarëve të Kosovës nga diskriminimi. Ky ligj parandalon diskriminim në bazë të karakteristikave që mund t'i kenë individë apo grupe të caktuara dhe fushëveprimi i tij zbatohet në të gjitha institucionet shtetërore dhe lokale, personat fizik apo juridik dhe sektorin publik apo privat të cilët shkelin, kanë shkelur apo mund të shkelin të drejtat njerëzore. Ligji i referohet diskriminimit direkt dhe indirekt dhe u garanton të drejta personave LGBTI+ dhe pakicave etnike ku përfshihet edhe komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian¹⁸. Ndër nenet e ligjit, tek definimi i llojeve të trajtimit të pabarabartë po ashtu përfshihet "diskriminimi i shumëfishtë" duke u definuar si: *Neni 4.1.10. Diskriminimi i shumëfishtë, ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe bazat e shumëfishta interpretohen në përputhje me rrethanat.*

2.1.3. Kodi Penal i Kosovës nr. 06/L-074

Kodi Penal i Kosovës rregullon veprat penale, ndër të cilat përfshihet është edhe akti i urrejtjes ku mes karakteristikave të tjera të mbrojtura janë edhe raca, orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Megjithatë, ky Kod Penal nuk ka përcaktuar krimin e urrejtjes dhe bazën mbrojtëse të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, por me amandamentimin e tij në vitin 2019 personat LGBTI+ gëzojnë mbrojtje më gjithëpërfshirëse.

13 Zyra për qeverisje të mirë (2017). Strategjia për përfshirjen e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë Kosovare 2017-2021.

14 TACSO (2015). Access to Education for Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo. Prishtinë.

15 Balkan Sunflowers (2019). Situata shëndetësore e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom në komunën e Fushë Kosovës dhe nëntesave sociale në fshatin Plemetin në komunën e Obiliqit. Marrur nga: www.balkansunflowers.org/site/assets/files/1149/situata_she_ndete_sore_e_komuniteteve_ashkali_egjiptian_dhe_rom_nu_komune_n_e_fushe_kosove_s_dhe_nde_rtesave_socia.pdf?fbclid=IwAR1xoPNjy-MGW4CL3mg6cGcxYxvDQ4vKXg1q0tMLk3c_2jvH9g9jAyDwcKpA

16 New National Insurance will save lives. Life Expectancy and Health in Kosovo's Roma, Ashkali and Egyptian Communities. Marrur nga: www.balkansunflowers.org/images/stories/pdf/kosana%20annual%20report_2015_web.pdf

17 Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Marrur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

18 Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi. Marrur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

Neni 70 - Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit

2.12. *Me rastin e caktimit të dënimit, gjykata merr parasysh por nuk kufizohet në rrethanat e mëposhtme rënduese: Nëse vepra penale është akt i urrejtjes, që nënkupton cilëndo veprë penale të kryer ndaj personit, grupit të personave, ose pronës, motivuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, identitetit gjinor, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronë, gjendjes ekonomike, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, ose për shkak të afërsisë me personat me karakteristikat e lartpërmendura, përveç nëse ndonjë nga këto karakteristika përbën element të veprës penale.*¹⁹

2.2. Diskriminimi i shumëfishtë, koncepti i përgjithshëm dhe përfshirja ligjore në nivelin ndërkombëtar dhe atë kombëtar.

2.2.1. Diskriminimi i shumëfishtë

Me diskriminim të shumëfishtë nënkuptojmë rastet kur dikush diskriminohet për shkak të më shumë se një karakteristike e cila është pjesë, apo perceptohet të jetë pjesë e identitetit të tij. Njerëzit kanë nuanca të shumëfishta të identitetit dhe mund ta identifikojnë veten, apo mund të jenë të definuar nga të tjerët, në baza të përkatësisë gjinore, seksit, orientimit seksual, nacionalitetit, etnicitetit, religjionit, statusit social, nevojave të veçanta, etj. Sipas studimit të Sandra Fredman mbi ndërthurshmërinë në Bashkimin Evropian, propozohen tre (3) mënyra kryesore të konceptualizimit të diskriminimit i cili ndodh në bazë të më shumë se një karakteristike.

- Diskriminimi i shumëfishtë vijues - nënkuptohet kur personi diskriminohet në disa baza por në raste të ndryshme. Për shembull, një grua me nevoja të veçanta në një rast mund të diskriminohet për shkak të përkatësisë gjinore kurse në rastin tjetër diskriminohet në bazë të nevojave të veçanta. Ky lloj i diskriminimit konsiderohet si më i lehti për t'u trajtuar pasi që secili incident mund të vlerësohet dhe gjykohet individualisht në përputhje me rrethanat.

- Diskriminim i shumëfishtë shtesë - nënkuptohet kur personi diskriminohet në bazë të dy karakteristikave por në të njëjtin rast. Për shembull kur një grua lezbike ngacmohet për shkak të përkatësisë së saj gjinore dhe orientimit të saj seksual. Ky lloj i diskriminimit është shtesë pasi që dy baza të shkeljes mund të identifikohen pavarësisht njëra nga tjetra.

- Diskriminim i ndërthurur - nënkupton situatën kur dy apo më shumë baza të shkeljeve operojnë në mënyrë simultane dhe bashkëveprojnë në mënyrë të pandashme, duke prodhuar forma të ndara dhe specifike të diskriminimit²⁰.

Në rastet kur ndodh diskriminimi dhe është e nevojshme t'i marim parasysh perspektivat e shumta, atëherë Makkonen (2002) parasheh se duhet të merren parasysh disa situata specifike:

- Viktimat kanë më shumë gjasa të diskriminohen më shpesh, për shkak të karakteristikave të ndryshme të identitetit të tyre që janë në rrezik në rastet e diskriminimit.

- Viktimat kanë më shumë të ngjarë të vuajnë nga format e rënduara të diskriminimit, të cilat janë më intensive dhe e bëjnë pozicionin e personit edhe më të prekshëm në shoqëri.

- Përvoja e viktimave, veçanërisht në rastin e diskriminimit ndër-sektorial, një përvojë tjetër e diskriminimit që është e vështirë të kategorizohen duke parë vetëm një terren në të njëjtën kohë.

- Viktimat gjithashtu kanë më shumë të ngjarë të vuajnë nga pabarazitë strukturore në shoqëri, varfëria dhe përjashtimi social dhe, përgjithësisht, nga marginalizimi, pasi të gjithë këta faktorë hyjnë në lojë. Kur e gjithë mendësia e shoqërisë nuk e lidh varfërinë, për shembull, me diskriminimin, episodet e fajësimit të viktimës ka gjithashtu më shumë të ngjarë të ndodhin. Ata që janë të varfër shihen si një problem, ndërsa struktura ekzistuese dhe proceset e diskriminimit në shoqëri mbeten të padukshme.

- Viktimat përfaqësohen në terma thelbësorë, dhe pakicat brenda një pakice mbeten të padukshme në sferën publike, ndërsa interesat e tyre gjithashtu injorohen, për shkak të diskriminimit nga brenda vetë grupit. Për shembull, romët homoseksualë janë të padukshëm brenda komuniteteve homoseksuale dhe të padukshëm brenda komuniteteve rome, ndërsa vuajnë nga përjashtimi nga të dy komunitetet²¹.

19 Kodi Penal i Kosovës. Marrur nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

20 Council of Europe. Intersectionality and Multiple Discrimination. Marrur nga: <https://www.coe.int/en/web/gender-matters/intersectionality-and-multiple-discrimination#:~:text=Intersectionality%20discrimination%20-%20happens%20when%20two,and%20specific%20forms%20of%20discrimination>

21 Makonnen, T. (2002). Multiple, Compound and Intersectional Discrimination: Bringing the experiences of the most marginalized to the fore. Institute for Human Rights, Åbo Akademi University. Marrur nga: <http://cilvektiesibas.org.lv/site/attachments/01/02/2012/timo.pdf>

2.2.2. Perspektiva ligjore e diskriminimit të shumëfishtë

Nga perspektiva ligjore, diskriminimi i shumëfishtë kërkon një reformë në mënyrën e trajtimit të diskriminimit në ligj, dhe në mjetet juridike në dispozicion të viktimave. Instrumentet ligjore janë, për momentin, në shumicën e vendeve evropiane, joadekuate pasi ato kërkojnë të ashtuquajturën “në bazë të një karakteristike të vetme”, ku personi që vuan diskriminimin duhet të bëjë kërkesën e tij bazuar vetëm në një bazë të diskriminimit. Ekziston një nevojë për mbrojtje të shtuar në ligj si dhe mjete juridike që pranojnë situatën specifike të atyre viktimave të diskriminimit të shumëfishtë.

Legjislativi aktual i Kosovës, në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi nr. 05/L-021 parasheh konceptin e diskriminimit të shumëfishtë dhe mbrojtjen nga diskriminimi i shumëfishtë në nenin 4, pika 1.10: “*Diskriminimi i shumëfishtë, ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe bazat e shumëfishta interpretohen në përputhje me rrethanat*”.

Gjithsesi vlen të ceket që deri më tani në Kosovë nuk është inicuar ndonjë diskutim nga institucionet e vendit në rrafshin e vet konceptit mbi trajtimin, përfshirjen dhe sfidave që personat hasin në diskriminim i cili prek më shumë se një karakteristike të personit. Termi “diskriminim i dyfishtë” pothuajse nuk përdoret fare nga institucionet shtetërore kurse nga organizatat e shoqërisë civile përdoret kryesisht për të adresuar sfidat me të cilat ballafaqohen viktimat të cilat i takojnë dy grupeve të caktuara të cilat janë të marginalizuara në Kosovë, për shembull: personat LGBTI+, gratë, personat rom, ashkalinjë, egjiptianët, personat me nevoja të veçanta, etj. Vlen të ceket që brenda institucioneve, format për raportim të shkeljeve nuk përmbajnë seksione të cilat do të evidentonin në mënyrë eksplicite nëse shkelja është e bazuar në më shumë se një karakteristike të personit. Nga institucionet e pavarura por as policia, prokuroria e as gjykatat nuk është treguar që kanë evidentuar apo dhe trajtuar me vetë-iniciativë ndonjë rast i cili nënkuptohej si diskriminim i shumëfishtë. Institucionet e pavarura si dhe institucionet si policia, prokuroria dhe gjykatat duhet të kenë konsideratë kur kemi të bëjmë me ndjeshmërinë e rasteve të diskriminimit në bazë të më shumë karakteristikave të personit, me theks të veçantë kur personat janë LGBTI+ dhe i takojnë pakicave etnike. Gjithashtu, institucionet mund të iniciojnë rekomandime për implementim më të mirë të Ligjit Për Mbrojtje nga Diskriminimi duke u bazuar në praktika të mira.

Vlen të ceket që në asnjë nga Institucionet Evropiane nuk përfshihet mbrojtja nga diskriminimi i shumëfishtë në mënyrë eksplicite. Sidoqoftë në tabelën e mëposhtme paraqitet se si janë të rregulluara dispozitat e diskriminimit të shumëfishtë në Kosovë, rajon dhe disa shtete të Evropës:

Shteti	Dispozitat
Kosova	Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi cek: Diskriminimi i shumëfishtë, ndodh kur diskriminimi është i bazuar në çfarëdo kombinimi mbi bazat e mbuluara me këtë ligj. Diskriminimi i shumëfishtë dhe bazat e shumëfishta interpretohen në përputhje me rrethanat.
Shqipëria	Me ndryshimet dhe shtesat në ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, që nga tetori i vitit 2020 diskriminimi i shumëfishtë mbrohet me ligj në Shqipëri. Neni 3, pika 4: Diskriminim i shumëfishtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.
Austria dhe Italia	Diskriminimi i shumëfishtë merret parasysh gjatë llogaritjes së kompensimit në një rast diskriminimi. Dispozitat ligjore përmendin mundësinë që të ndodhë diskriminimi i bazuar në më shumë se një prej arsyeve të ndaluara.
Kroacia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut	Legjislativi garanton mbrojtjen kur nxitja për diskriminim përfshin segregimin, diskriminim e shumëfishtë si dhe viktimizimin.
Polonia	Legjislativi parashikon shprehimisht që diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë mund të bazohet në më shumë se një bazë të shkeljes.
Qipro, Danimarka, Franca, Islanda, Irlanda, Malta, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Suedia	Legjislativi kombëtar lejon paditësin/en të paraqesin ankesat për diskriminim të shumëfishtë. Në disa raste, legjislativi kombëtar ‘nënkupton në heshtje’ ekzistencën e formave të tilla të diskriminimit.
Bulgaria	Një përkufizim themelor i diskriminimit të shumëfishtë gjendet në dispozitat e Aktit Bullgar të Mbrojtjes nga Diskriminimi. Sipas ligjit, autoritetet publike janë nën një detyrim pozitiv të hartojnë politika dhe të kryejnë sondazhe mbi diskriminimin e shumëfishtë.
Rumania	Në tetor të viti 2020, Parlamenti i Rumanisë ka propozuar rregullimin e diskriminimit të shumëfishtë duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> • Definimin dhe rregullimin e diskriminimit të shumëfishtë duke marrë për bazë shtetësinë dhe ngjyrën e lekurës. • Sanksione më të ashpra për segregimin në të gjitha fushat e jetës përfshirë këtu edhe promovimin e segregimit.

3. INSTITUCIONET E PAVARURA DHE ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

3.1.1. Institucionet e pavarura ku mund të raportohet diskriminimi

Si institucion i pavarur kyç në Kosovë është Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) kompetencat e të cilit janë të përcaktuara sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me Ligjin Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, rregullohet organizimi dhe funksionimi, përgjegjësitë, mënyra e punës së IAP-së si dhe procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre.

Avokati i Popullit paraqet mekanizmin ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera, të cilët ushtrojnë detyra publike në Republikën e Kosovës. Ky institucion po ashtu vepron si mekanizëm kombëtar për parandalim e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jo njerëzore dhe poshtëruese, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjithashtu, Avokati i Popullit është mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, të cilat, bashkë me Ligjin për Avokatin e Popullit përbëjnë pakon ligjore të të drejtave të njeriut, e cila ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015²².

Institucioni i Avokatit të Popullit, si organ i pavarur, sikur dhe institucionet tjera kombëtare nuk përfshijnë në formularët e tyre ndonjë segment të diskriminimit të shumëfishtë. Sidoqoftë, në mënyrë që të dokumentohen shkeljet të cilat bëhen në bazë të disa karakteristikave të personit, IAP-i duhet të shqyrtojë me kujdes rastet të cilat mund të konsiderohen si diskriminim i shumëfishtë, me theks të veçantë për personat Rom LGBTI+, sidomos duke patur parasysh ndjeshmërinë e këtyre dy grupeve si ndër më të marginalizuarit në Kosovë. IAP-i gjithashtu duhet të iniciojë diskutime dhe japë rekomandime drejtuar institucioneve relevante që merren me mbrojtjen nga diskriminimi me qëllim të rritjes së vetëdijës mbi vetë rëndësinë e zbatimit të duhur të legjislacionit i cili tashmë e parashikon diskriminimin e shumëfishtë si formë diskriminimi.

Në institucionin e IAP-it, mund të raportohen direkt rastet e diskriminimit apo ankesat ndaj institucioneve shtetërore. Raportimet e tilla mund të ndodhin duke u drejtuar direkt tek zyra qendrore apo ato rajonale të Institucionit të Avokatit të Popullit; Por gjithashtu edhe në bazë të ankesave me shkrim që mund të dërgohen përmes platformës digjitale tek webfaqja e Avokatit të Popullit, përmes postës, faksit etj.

²² Institucioni i Avokatit të Popullit. Marrë nga: <https://www.Insoik-rks.org/per-ne/>

Formati i ankesës është si më poshtë:

REPUBLICA E KOSOVËS
INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT
PARAQIT RASTIN 0800 15555 THIRIA FALAS

BALLINA PËR NE STRUKTURA LEGJISLACIONI RAPORTET PROJEKTE PUBLIKIME KONTAKTE

FORMULARI I ANKESËS

1. Informatat personale

Emri dhe mbiemri* Vendlindja*

Adresa, rruga dhe numri* Datëlindja*

Numri personal* Gjinia*

Përkatësia etnike*

Kodi postar, vendi dhe komuna*

E-mail*

2. Kundër cilit institucion publik në Republikën e Kosovës parashtroni ankesë?

Emri i institucionit*

3. Përshkrim i shkurtër i ankesës

Përshkrimi*

Ju lutem përshkruani ankesën në mënyrë të qartë dhe të shkurtër. Na thoni datën kur ka ndodhur rasti, nëse iu keni drejtuar ndonjë autoriteti më parë, nëse rasti i juaj është në shqyrtim te ndonjë autoritet publik apo te ndonjë gjykatë.

No file chosen

[KTHEHU NË FILLIM](#)

3.1.2. Organizatat e shoqërisë civile që punojnë dhe ofrojnë shërbime në këtë fushë

Në Kosovë, punojnë disa organizata të shoqërisë civile që synojnë advokimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të kategorive të veçanta/grupeve shoqërore që janë të marginalizuara. Ndër to, janë dy organizata që kanë fokus punën me personat LGBTI+ në Kosovë, duke dizajnuar kështu aktivitetet dhe shërbimet e tyre në mënyrë gjithëpërfshirëse. Përveç organizatave që punojnë me personat LGBTI+, ekzistojnë edhe të tjera që synojnë përfshirjen dhe ofrimin e shërbimeve për personat Rom, Ashkali dhe Egjiptian si Rrogarek, Balkan Sunflowers, Roma Versitas Kosovo.

Në organizatat e shoqërisë civile si Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD) dhe Qendra për Liri dhe Barazi (CEL), ndër shërbimet pa pagesë që janë në dispozicion janë: shërbimet juridike/ndihma ligjore falas dhe shërbimet psikologjike/seancat individuale psikologjike dhe asistimi psikiatrik. Në rastet e ballafaqimit me diskriminim, shkelje të të drejtave dhe raportim të rasteve, këto organizata janë të disponueshme për kërkim ndihme. CSGD shërbimet e saj i ka adaptuar edhe në formë digjitale, ku ekziston edhe platforma për kërkimin e ndihmës ligjore falas duke u lidhur direkt me ekspertët e çështjeve juridike²³.

²³ <https://app.csgd-ks.org/>

4. MJETET PRAKTIKE DHE STRATEGJITË PËR TË TRAJTUAR DISKRIMINIMIN E SHUMËFISHTË

4.1.1. Regjistrimi dhe dokumentimi i diskriminimit të shumëfishtë

Rekomandime për raportimin dhe dokumentimin e diskriminimit të shumëfishtë:

1. Kërkim i ndihmës juridike falas brenda organizatave që merren me mbrojtjen dhe promovimin e personave LGBTI+ në Kosovë - Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD) dhe Qendra për Barazi dhe Liri (CEL) si dhe të atyre organizatave që merren me komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian psh. Rogarek.
2. Personat Rom, Ashkali dhe Egjiptian LGBTI + duhet që rastet e shkeljeve t'i raportojnë në polici dhe gjatë raportimit të theksohet nëse personi mendon që është diskriminuar në bazë të më shumë se një karakteristike.
3. Të raportohen rastet edhe tek Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) si dhe të kërkohet monitorim i rastit nëse vlerësohet që diskriminimi i shumëfishtë nuk po merret parasysh si bazë.

CSGD: www.csgd-ks.org

CEL: www.cel-ks.org

RROGAREK: www.rrograek.org

Platforma për ndihmë juridike falas: www.app.csgd-ks.org

IAP: www.oik-rks.org

4.1.2. Efektet psiko-sociale të diskriminimit të shumëfishtë

Rrethanat sociale definojnë kualitetin jetësor të individëve dhe përfshirjen e tyre në shoqëri. Studimet tregojnë se personat që janë subjekt i diskriminimit kanë predispozita më të larta për të pasur edhe vështirësi tjera të shëndetit emocional. Kësisoj, për personat LGBTI+ dhe Rom, Ashkali dhe Egjiptian ashtu siç u përshkrua në fillim, diskriminimi është pjesë e pandashme e realitetit ditor. Të gjeturat e deritanishme tregojnë një lidhje pozitive mes diskriminimit të shumëfishtë dhe depresionit, e kjo është më e shprehur në vendet me prosperitet ekonomik më të ulët²⁴. Në Kosovë, kërkimi i shërbimeve psiko-sociale mund të bëhet në qendrat e ndryshme të shëndetit, në klinikat private dhe në disa prej organizatave të shoqërisë civile. Duke pasur parasysh teorinë e stresit të pakicave, mekanizmat e tillë duhet të kushtojnë rëndësi aspekteve të ndryshme të identitetit dhe ofrimin e shërbimeve që janë gjithëpërfshirëse për të gjithë.

²⁴ Alvarez-G. & Rojas-G. (2019). A. Measuring the impact of multiple discrimination on depression in Europe. BMC Public Health 19, 435 (2019).

Rekomandime për marrjen e shërbimeve psiko-sociale:

1. Përfshirja në aktivitetet ekstra-kurrikulare dhe diskutimet mbi shëndetin mendor dhe rëndësinë e tij.
2. Identifikimi i grupeve mbështetëse brenda organizatave.
3. Përfshirja në punëtori dhe diskutime rreth çështjeve të shëndetit mendor, në organizatat e shoqërisë civile. Frekuentimi i qendrave “Drop-In”.
4. Kërkimi i ndihmës psikologjike në organizatat e shoqërisë civile apo platformat tjera online të cilat ofrojnë këtë shërbim pa pagesë dhe me konfidencialitet të plotë. Disa prej burimeve të kërkimit të ndihmës psikologjike janë: Organizatat CSGD dhe CEL, Linja e Jetës, Nuk je vet, Shëndeti Mendor-UP.

CSGD: www.csgd-ks.org

CEL: www.cel-ks.org

Linja e Jetës: 0800 12345

Nuk je vet: www.nukjevet.net

Shëndeti mendor-UP: <https://shendetimendor.uni-pr.edu/>

4.1.3. Gjetja e aleatëve dhe ndërtimi i komunitetit

Përmes fuqizimit të vetë komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe personave LGBTI+, krijohet një hapësirë e përshtatshme për identifikim dhe ngritje kapacitetesh brenda këtyre grupeve. Identifikimi dhe krijimi i hapësirës për aktivistë/e të rinj/reja siguron që komunitetet të jenë më të zëshëm në kërkimin e të drejtave të tyre. Përpos personave brenda komuniteteve, aleatët luajnë rol të rëndësishëm në promovimin dhe pranueshmërinë më të gjërë brenda shoqërisë.

Rekomandime mbi gjetjen e aleatëve dhe ndërtimin e komunitetit:

1. Frekuentimi i hapësirave të sigurta për personat Rom, Ashkali dhe Egjiptian LGBTI+. Këto hapësira ndryshe njihen edhe si qendra “Drop-in” e që në Kosovë janë dy, tek organizatat CSGD dhe CEL.
2. Përfshirja në aktivitete, evente, punëtori dhe trajnime që ndihmojnë përmirësimin e kapaciteteve dhe aktivizmit social.

4.1.4. Mbledhja e mbështetjes publike kundër diskriminimit - fushata (veprime publike dhe dixhitale, peticione, advokim)

Aktivitetet publike të cilat e përfshijnë masën e gjërë dhe jo vetëm grupet e synuara, rrjedhimisht ndikojnë në rritje të vetëdijës dhe rritje të numrit të mbështetësve.

Rekomandime për mbledhjen e mbështetjes publike kundër diskriminimit - fushata:

1. Marrja e iniciativave për të propozuar apo organizuar kampanja që adresojnë çështjet e personave LGBTI+ Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
2. Krijimi i aksioneve publike që adresojnë çështjen e diskriminimit të shumëfishtë.

5. Burime/Kontakte:

Organizatave e shoqërisë civile dhe burime të tjera për kërkim ndihme:

1. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)- <https://www.oik-rks.org/>
2. Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD)- www.csgd-ks.org
3. Qendra për Liri dhe Barazi (CEL)- www.cel-ks.org
4. Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës- <http://rrograek.org/>
5. Roma Versitas Kosovo- <http://www.romaversitas.org/>
6. Ballkan Sunflowers- <http://www.balkansunflowers.org/>
7. Linja e Jetës: 0800 12345
8. Nuk je vet: www.nukjevet.net
9. Shëndeti mendor-UP: <https://shendetimendor.uni-pr.edu/>
10. Platforma online për ndihmë ligjore nga CSGD- <https://app.csgd-ks.org/>

BIBLIOGRAFIA:

Abrams, D., Hogg, M.A. & Marques, J.M. (2005). *The Social Psychology of Inclusion and Exclusion*. New York: Psychology Press.

Alvarez-G. & Rojas-G. (2019). A. Measuring the impact of multiple discrimination on depression in Europe. *BMC Public Health* 19, 435 (2019).

Balkan Sunflowers (2019). Situata shëndetësore e komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom në komunën e Fushë Kosovës dhe ndërtesave sociale në fshatin Plemetin në komunën e Obiliqit. Marrë nga: www.balkansunflowers.org/site/assets/files/1149/situata_she_ndete_sore_e_komuniteteve_ashkali_egjiptian_dhe_rom_ne_komune_n_e_fushe_kosove_s_dhe_nde_rtesave_socia.pdf?fbclid=IwAR1xoPNjy-MGW4CL3mg6cGcxYxDQ4vKXg1q0tMLk3c_2jvH9g9jAyDwcKpA

Civil Rights Defenders (2017). The wall of anti-Gypsyism. Marrë nga: <https://crd.org/wp-content/uploads/2018/03/The-Wall-of-Anti-Gypsyism-Roma-in-Kosovo.pdf>

Council of Europe. Intersectionality and Multiple Discrimination. Marrë nga: <https://www.coe.int/en/web/gender-matters/intersectionality-and-multiple-discrimination#:~:text=Intersectional%20discrimination%20-%20happens%20when%20two,and%20specific%20forms%20of%20discrimination>

Crenshaw, K. (1993). Mapping the Margins: Intersectionality, Identity Politics, and Violence Against Women of Color. *Stanford Law Review* Vol. 43, No. 6

Gross, Larry (1991). Out of the Mainstream: Sexual Minorities and the Mass Media. *Journal of Homosexuality* 21(1/2):19-46

Institucioni i Avokatit të Popullit. Marrë nga: <https://www.insoik-rks.org/per-ne/>

Kodi Penal i Kosovës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

Makonnen, T. (2002). Multiple, Compound and Intersectional Discrimination: Bringing the experiences of the most marginalized to the fore. Institute for Human Rights, Åbo Akademi University. Marrë nga: <http://cilvektiesibas.org.lv/site/attachments/01/02/2012/timo.pdf>

Meyer I. H. (2003). Prejudice, social stress, and mental health in lesbian, gay, and bisexual populations: conceptual issues and research evidence. *Psychological bulletin*, 129(5), 674–697.

Minority Right Group International (2018). Roma, Ashkali and Egyptians. Marrë nga: <https://minorityrights.org/minorities/roma-9/>

National Democratic Institute (2015). LGBTI Public Opinion Poll in Western Balkans. Marrë nga: <https://www.lgbti-era.org/sites/default/files/pdfdocs/LGBT%20Poll%202015%20Western%20Balkans%20NDI%20.pdf>

New National Insurance will save lives. Life Expectancy and Health in Kosovo's Roma, Ashkali and Egyptian Communities. Marrë nga: www.balkansunflowers.org/images/stories/pdf/kosana%20annual%20report_2015_web.pdf

Renzetti, C. & Edleson, J. (2008). *Encyclopedia of Interpersonal Violence*. SAGE Publications.

TACSO (2015). Access to Education for Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo. Prishtinë. World Bank Group (2018). Life on the Margins: Survey Results of the Experiences of LGBTI People in Southeastern Europe. Marrë nga: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/123651538514203449/pdf/130420-REPLACEMENT-PUBLIC-FINAL-WEB-Life-on-the-Margins-Survey-Results-of-the-Experiences-of-LGBTI-People-in-Southeastern-Europe.pdf>

YIHR (2013). Liria dhe mbrojtja për lezbiket, homoseksualet, biseksualet dhe transgjinoret në Kosovë. Marrë nga: https://ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf

Zyra për qeverisje të mirë (2017). Strategjia për përfshirjen e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas në shoqërinë Kosovare 2017-2021. Marrë nga: <https://kryeministri-ks.net/documents/strategjia-per-perfshirjen-e-komuniteteve-rom-dhe-ashkali-ne-shoqerine-kosovare-2017-2021/>



MANUAL PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI I SHUMËFISHTË

Për anëtarët e komunitetit
Rom, Ashkali dhe Egjiptian
LGBTI + në Kosovë